



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 2670/19 Prot.

Tirane, më 17.10 2023

VENDIM
Nr. 71 dt. 17.10 2023

**“PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË TARIFËS SË KONTROLLIT TË TESTIT FIZIK SPECIFIK,
PËR STUDENTËT QË KANË REZULTUAR FITUES DHE JANË RREGJISTRUAR NË CIKLIN
E PARË TË STUDIMEVE TË PROGRAMIT BACHELOR PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, të nenit 3, të nenit 6, të nenit 49, në Statutin e UST-së, neni 7, 43, në Rregulloren e UST-së, shkresën e FSHL nr. 2381 datë 29.09.2023, në Vendimin e Senatit nr.79 datë 14.07.2023, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.53 datë 19.07.2023 “Për miratimin e kontrollit fizik specifik për përballimin fizikisht të programit të studimit për studentët fitues në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 107 datë 05.10.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 17.10.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën për kontrollin mjekësor: PWC që kryhet nëpërmjet biçikletës ergometrike MONARK, për matjen e peshës dhe lartësisë trupore, për të gjithë studentët e Ciklit të parë të programit bachelor, që kanë rezultuar fitues dhe janë regjistruar në vitin akademik 2023-2024, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në Universitetin e sporteve të Tiranës.
2. Tarifa të jetë në shumën 2500 lekë (dymijë e pesëqind) Lekë
3. UST të konsiderojë mundësinë e përfshirjes së tarifës së testit fizik specifik në paketën e kriterëve dhe kërkesave të pranimit të studentëve.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Drejtoria e Fiancës dhe Buxhetit, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek Transparenca Universitare

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

P/ ARTUR COBANI

Artur Cobani

